



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. ____ Prot

Tiranë, më ____2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data: 01.09.2020]

Për: “ALBANIA MOTOR COMPANY” SHPK

Adresa: Kashar, Tiranë

* * *

Proçedura e prokurimit: “**Proçedurë e hapur**” -Mallra- me objekt: “**Blerje autoambulanca për plotësimin e nevojave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** ” me fond limit: **196,371,000** (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë) **lekë pa TVSH**, me numër reference **REF-64308-07-06-2020**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Blerje autoambulanca për plotësimin e nevojave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**” me fond limit: **196,371,000** (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë) **lekë pa TVSH**, dhe me numër reference: **REF-64308-07-06-2020**, me afat lëvrimi brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Publikime të mëparshme (jo): Buletini i Njoftimeve Publike 13.07.2020, Nr.42.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1) “ALBANIA MOTOR COMPANY” SHPK **K41829010I**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera: **191,505,600** (njëqind e nëntëdhjetë e një milion e pesëqind e pesë mijë e gjashtëqind) lekë (pa TVSH) (*me numra dhe fjalë*)
- 2) “CLASSIC” SHPK **J91909004J**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera: **196,000,000** (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion) lekë (pa TVSH) (*me numra dhe fjalë*)
- 3) BOE “TIMAC” SHPK dhe “START CO” SHPK **L62030020B, L11614001S**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera: **179,280,000** (një qindë e shtatëdhjetë e nëntë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë).

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. Arsyeja e skualifikimit për “CLASSIC” SHPK

- Operatori ekonomik “Classic” SHPK nuk arriti të paraqesë dokumentacionin e kërkuar në DT pasi rezultoi të ketë praqitur ofertën ekonomike, pasqyrat financiare dhe xhiro vjetore.

2. Arsyeja e skualifikimit për BOE “TIMAC” SHPK dhe “START CO” SHPK

- Operatori ekonomik rezultoi të ketë praqitur ofertë në këtë procedurë prokurimi si bashkim operatorësh ekonomik dhe referuar dokumentit të hedhur në SPE dhe të emërtuar “Marrëveshja për bashkim ekonomik” në përmbajtje të të cilit është dokumenti noterial: “Marrëveshje Bashkëpunimi për bashkimin e përkohshëm të dy shoqërive” me nr.REP 4043 dhe nr.KOL 1002, datë 03.08.2020.
- Në këtë marrëveshje operatorët ekonomik kanë përcaktuar se anëtari i BOE “Timak” SHPK do të përballojë 60% të volumit dhe anëtari tjetër i BOE “START –CO” SHPK do të përballojë 40% të volumit. Gjithashtu deklarohet se:... realizimi i objektit do të kryhet nga operatorët sipas ndarjes së mësipërme, në kuptim të atij financimi duke krye rvolumin e punëve që detajohet sipas përshkrimit të mësipërm dhe në dokumentin bashkëngjitur...”. Në SPE si pjesë të ofertës së tij ofertuesi nuk rezultoi të ketë praqitur asnjë dokument ku përcaktohet ndarja e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi operatorësh ekonomik, në kundërshtim kjo me pikat 1 dhe 2 të nenit 74 të VKM 914/2014, i ndryshuar ku përcaktohet se:...*Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi...*” si dhe “...Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi...”

1. Anëtari i BOE “START –CO” SHPK nuk rezultoi të ketë praqitur si pjesë të ofertës të praqitur nga BOE “TIMAK” SHPK dhe “START –CO” SHPK, dokumentacionin e kërkuar në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në Shtojcën 9 të DT, në raport me pjesëmarrjen e tij në BOE prej 40% të volumit të kontratës e konkretisht:

Operatori ekonomik “START –CO” SHPK, nuk arriti të provojë se ka realizuar furnizime të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës. Ky anëtar i BOE –së referuar pjesëmarrjes në këtë bashkim operatorësh duhet të praqistedokumentacion provues për realizimin e furnizimeve të ngjashme në vlerën prej jo më pak se **31,419,360** (tridhjetë e një milion e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH. Nga verifikimi i dokumentacionit të praqitur si pjesë e ofertës të dorëzuar në SPE për këtë procedurë prokurimi rezultoi të ketë praqitur furnizime të ngjashme në vlerën prej **13,494,650 lekë pa TVSH**. Furnizimet e deklaruara me faturat tatimore me nr. 40 datë 02.05.2019; me nr.41 datë 02.05.2019 dhe me nr.95 datë 11.11.2019 nuk vlerësohen si furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit.

2. Anëtari i BOE “START –CO” SHPK, nuk arriti të provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
3. Anëtari i BOE “START –CO” SHPK, nuk arriti të paraqesë një deklaratë që garanton dhe merr përsipër se autoambulanca dhe pajisjet mjekësore që do të ofertojë janë të prodhuara dhe përmbushin kërkesat, certifikimet dhe standardet e cilësisë të përcaktuara në specifikimet teknike në DST, si dhe faktin se të gjitha certifikatat për standartet e cilësisë duhet të shoqërojnë mallin në momentin e marrjes në dorëzim.
4. Anëtari i BOE “START –CO” SHPK nuk arriti të paraqesë një deklaratë ku të ku të përshkruajë dhe të specifikojë: kompaninë prodhuese, modelin A dhe vendin e prodhimit të automabulancës, si dhe modelin dhe vitin e prodhimit të automjetit.
5. Anëtari i BOE “START –CO” SHPK nuk arriti paraqesë katalogë teknikë/ broshura ose çdo lloj dokumentacioni tjetër teknik, të autoambulancës model A, ku të përfshihen specifikimet teknike të automjetit dhe kabinës së pacientit, të përkthyer dhe noterizuar. Në katalogë/ broshura duhet të markoheshin nga OE (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën 10 të DT.
6. Anëtari i BOE “START –CO” SHPK nuk arriti të paraqesë katalogë teknikë/ broshura ose çdo lloj dokumentacioni tjetër teknik, të pajisjeve dhe aparaturave mjekësore të kabinës së pacientit të autoambulancës model A, që vërteton plotësimin e specifikimeve teknike, të përkthyer dhe noterizuar. Në katalogë/ broshura duhet të markoheshin nga OE (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike të kërkuara në Shtojcën 10 të DT.
7. Anëtari i BOE “START –CO” SHPK nuk arriti të paraqesë një deklaratë që merr përsipër dhe garanton mbulimin e periudhës së garancisë sipas përcaktimeve në specifikimet teknike në DST (duke përfshirë 5 vjet garancinë për automjetin, 2 vjet garancinë për autoambulancën (kabinën e pacientit) dhe 2 vjet garancinë për pajisjet dhe aparaturat mjekësore).
8. Anëtari i BOE “START –CO” SHPK nuk arriti të paraqesë deklaratë që mallrat e ofruar (autoambulancat, pajisjet dhe aparaturat mjekësore) janë të reja, të papërdorura dhe origjinale;
9. Anëtari i BOE “TIMAK” SHPK nuk arriti të provojë se ka realizuar furnizime të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës. Ky anëtar i BOE –së referuar pjesëmarrjes në këtë bashkim operatorësh duhet të paraqiste dokumentacion provues për realizimin e furnizimeve të ngjashme në vlerën prej jo më pak se **47,129,040** lekë pa TVSH. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur si pjesë e ofertës të dorëzuar në SPE për këtë procedurë prokurimi rezulton të ketë paraqitur furnizime të ngjashme në vlerën prej **26,488,648 lekë pa TVSH**. Furnizimet e deklaruara me vërtetimin me nr. 49560/1 prot., datë 31.12.2019 me faturat tatimore me nr. 40 datë 02.05.2019; me

nr.41 datë 02.05.2019 i lëshuar nga Bashkia Tiranë, nuk vlerësohet si furnizim i ngjashëm me objektin e prokurimit.

9.1 Anëtari i BOE "TIMAK" SHPK rezulton të ketë paraqitur si pjesë e ofertës së tij dokumentit të emërtuar: "Fatura", me numër të faturës 00047, me datë të faturës 14.07.2020; faturuar: UNCHR bo Libya. Në lidhje me këtë dokument KVO në mbështetje të pikës 4 të nenit 30 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar; të pikës 2 të nenit 66, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ka kryer verifikime pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë e cila me shkresën me nr.19145/1 prot., datë 18.08.2020 (protokolluar me tonën me nr.1585/2 datë 20.08.2020) ka konfirmuar se.... *dokumentit të emërtuar: "Fatura", me numër të faturës 00047, me datë të faturës 14.07.2020, nuk është faturë tatimore e parashikuar dhe e përpiluar në formën e caktuar, të miratuar nga Ministri i Financave sic parashikohet në ligjin nr.92/14 datë 24.07.2014 për TVSH-në neni 101. Gjithashtu nuk është faturë tatimore kompjuterike e shitjes e autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve... "*

Sa më sipër, dokumentit i emërtuar: "Fatura", me numër të faturës 00047, me datë të faturës 14.07.2020; faturuar: UNCHR bo Libya, nuk konsiderohet i vlefshëm pasi nuk është faturë tatimore konform legjislacionit në fuqi.

10. Anëtari i BOE "TIMAK" SHPK rezulton të ketë deklaruar se është prodhues i ambulancës si dhe *"vend i prodhimit te autoambulances do te jete Shqiperia (Made in Albania),* por si pjesë të ofertës së tij në SPE nuk rezulton të ketë paraqitur dokumentacion që vërteton plotësimin e kriterit "Specifikimet Teknike, paragrafi I, pika 11: *Furnizimi dhe montimi i pajisjeve dhe atrecatures ne Autoambulanca, sipas kerkesave te dhena nga AK, duhet te kryhet nga prodhuesi i autoambulances ose nje operator i autorizuar prej tij dhe i certifikuar sipas legjislacionit ne fuqi.*" Pra, ofertuesi nuk arriti të provojë se është nga kompania prodhuese "FIAT", në mënyrë që furnizimi, montimi i pajisjeve dhe atrecatures se autoambulancës te behet ne Shqipëri nga Anëtari i BOE "TIMAK" SHPK.

11. Anëtari i BOE "TIMAK" SHPK, në përmbushje të kriterit "2.3 Kapaciteti teknik, pika 5", ka paraqitur katalogun teknik në të cilin nuk rezulton të jenë markuar te dhenat teknike duke mos përcaktuar qartë se me çfarë tipi automjeti ka ofertuar, pasi ka paraqitur disa modele ne teësi (30, 33, 35) duke mos deklaruar qartë llojin e mjetit me të cilin ka ofertuar. Ne katalogun teknik nuk jane paraqitur te dhena teknike ne lidhje me: vitin e prodhimit te mjetit, Tipi i motorrit (Naftë apo benzin), kapaciteti ne litra (minimalisht 2 litra), shenim i emetimit te gazrave (Euro 6), llojin e kambios (manual apo automatike), transmisioni (minimum me 6 marshe), fuqia maksimale motorrike ne kf, kapacitetin e serbatorit, sistemin e nisjes nga vendi ne te perpjete (hill start assist), sensor parkimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomik të suksesshëm:

1) **"ALBANIA MOTOR COMPANY" SHPK**
Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it
K41829010I

Renditet i pari

Vlera: **191,505,600** (njëqind e nëntëdhjetë e një milion e pesëqind e pesë mijë e gjashtëqind)
lekë (pa TVSH) *(me numra dhe fjalë)*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me adresë: Rr.e Kavajës, 1001, Tiranë, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.08.2020

Ankesa: Jo

TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS
DREJTOR I PËRGJITHSHËM